



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 3577 Prot

Lezhë, më 30 / 3 /2023

VENDIM

Nr. 19, Datë 29. 03.2023

PËR

MIRATIMIN E PLAN-MASAVE PËR PARANDALIMIN, MENAXHIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA SI DHE KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE PËR VITIN 2023

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Per funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 “Për Pyjet” neni 30 pika 4 gërma c, ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kulllosor” i ndryshuar, në ligjin Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligjin Nr. 45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ligjin Nr. 152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, VKM-në nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”, pas shqyrtimit të Planit të Masave, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. Të miratojë Planin e Masave për parandalimin, menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe krijimin e Njësive Vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2023.
2. Për krijimin e Njësive Vullnetare ngarkohen Njësiti Administrative.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia e Administrimit të Pyjeve pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE ✓
NJËSIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
PJERIN NDREU



PLAN MASASH

Nr ~~7857~~ datë 10.3.2023.

PËR

PARANDALIMIN, MENAXHIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE PËR VITIN 2023

Baza Ligjore :

Ligji nr Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”.

Ligji Nr. 57 datë 30.04. 2020 “Për Pyjet”

Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar.

Ligji Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Ligji Nr. 45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”

Ligji Nr. 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

VKM 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”.

Përkufizime:

“**Rrezik zjarri**” është situata e krijuar nga akumulimi i faktorëve që nxitin mundësinë e nisjes së zjarrit dhe zhvillimit të tij.

“Sisteme të diktimit-sinjalizimit” janë pajisje që diktojnë, sinjalizojnë shfaqjen e tymit, gazrave dhe zjarrit.

“Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri” është organizimi i strukturës vullnetare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, nga organet e njësitë e qeverisjes vendore, nga personat juridikë, që kryejnë veprimtaritë e tyre në Republikën e Shqipërisë, nga institucione dhe agjenci shtetërore, të cilat kanë përgjegjësi për administrimin e pasurive shtetërore me rrezikshmëri nga zjarri.

“Zjarr” është dukuria e djegies, e shoqëruar me nxehtësi të lartë, tym dhe dritë në formë flakësh përcëlluese.

“Zjarr normal” është zjarri që shkakton dëm, për përballimin e të cilit janë të mjaftueshme forcat operacionale, mjetet dhe pajisjet e stacionit zjarrfikës të Bashkisë.

“Zjarr masiv” është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera.

“Zjarr me përmasa të mëdha” është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

“Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtim” është tërësia e masave tekniko-organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës.

“Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore” është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

“Pyll bashkiak” është pylli në pronësi apo në përdorim të organeve të qeverisjes vendore.

“Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore” është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

“Emergjencë civile” është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

“Fatkeqësi natyrore” janë fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje,

sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

“**Mbrojtja civile**” është tërësia e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

Në rast se në fondin pyjor ose në një pjesë pylli, shkurre apo kullotë bie zjarr, organet e shërbimit pyjor, organet e njësive të qeverisjes vendore, çdo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe çdo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë për shuarjen e tij.

Bashkia Lezhë me strukturat e saj, Njësitë Administrative, Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, në zbatim të dispozitave ligjore si më sipër, për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në administrim të saj parashikon marrjen e masave organizative si më poshtë:

- Në rastet e zjarreve në pyje dhe kullota në territorin e Bashkisë Lezhë ngrihet dhe funksionon shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i cili drejton dhe organizon gjithë veprimtarinë për “Organizimin e ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin”.
- Ky shtab kryesohet nga **Z. Pjerin Ndreu** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga:

Z. Ermal Pacaj **Zv/Kryetar i Bashkisë Lezhë, Sekretar i Shtabit.**

Z. Bardhul Kaçorri **Drejtor i Drejtorisë së Emergjencave Civile MZSH.**

Z. Martin Gjini **Drejtor i Drejtorisë së MZSH**

Z. Leonard Palaj **K/inspektor i Policisë Bashkiake.**

Z. Marta Fetaj **Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social.**

Z. Nikolin Prendi **Drejtor Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve.**

Z. Gjergj Malshi **Administrator, Njësia Administrative Zejmen.**

Z. Fatjon Zefi **Administrator, Njësia Administrative Kolsh.**

Z. Bjord Malaj **Administrator, Njësia Administrative Shëngjin.**

Z. Sandër Marashi **Administrator, Njësia Administrative Balldre.**

Z. Eraldo Marku **Administrator i komanduar, Njësia Administrative Kallmet.**

Zj. Luiza Marku **Administrator, Njësia Administrative Blinisht.**

Z. Agustin Zefi **Administrator, Njësia Administrative Ungrej.**

- Pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, ngrihet shtabi i Drejtorisë i cili ka të organizuar sistemin e vrojtimit-sinjalizimit me anë të strukturës së Rojtarëve dhe Teknikëve, persona përgjegjës të zonave pyjore.
- Të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Lezhë të organizojnë/riorganizojnë “Shërbimin vullnetar të mbrojtjes nga zjarri”. Këto skuadra përbëhen nga 8-10 anëtarë dhe do të mbahen në eficiencë të plotë nga Njësitë Administrative nëpërmjet Rojtarëve dhe Teknikëve, persona përgjegjës të zonave pyjore brenda territorit të Njësisë. Skuadra e “Shërbimit vullnetar të mbrojtjes nga zjarri” do të jenë strukturat e para që së bashku me strukturat e tjera pyjore do të mbajnë nën kontroll zjarrin deri në mbërritjen e forcave dhe mjeteve që do të organizohen nga Shtabi i Bashkisë Lezhë. Afati i realizimit: **mars 2023**.
- Struktura e Njësisë Vullnetare për shuarje Zjarri, Rojtarëve dhe Teknikëve (persona përgjegjës të zonave pyjore), nëpërmjet Drejtorisë së Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi do të trajnohen dhe kualifikohen për mënyrën e shuarjes së zjarrit në pyje dhe kullota. Afati i realizimit :**deri më 15 maj 2023**.
- Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave të saj Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe MZSH, shoqatave të ndryshme të pyjeve etj do të organizojë biseda me komunitetin e Zonave Pyjore, nxënësve të shkollave në këto zona mbi sensibilizimin e opinionit për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave : **Afati i realizimit, gjatë gjithë vitit**.
- Harta e Zonave të Rrezikuara nga Zjarri për Pyjet/Kullotat e cila përmban të gjithë objektet e ekspozuara nga zjarret, largësitë e tyre nga qendrat e banuara pikat e vrojtimit sinjalizimit, rrugët për lëvizjen e mjeteve në territorin e Bashkisë Lezhë, do të bëhet publike në të gjitha Njësitë Administrative të cilat kanë zonë pyjore të rrezikuara, shkollat si edhe ambiente të tjera publike. Kjo hartë do të vihet në dispozicion edhe Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe MZSH. Afati i realizimit: **maj 2023**.
- Punonjësit e Njësisë së Administrimit të Pyjeve pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Rojtarët dhe Teknikët pyjorë (persona përgjegjës për zonat pyjore) detyrohen të mbajnë takime me Administratorët e Njësisë Administrative, komunitetin, barinjtë në kullota, subjekte të tjera që veprojnë në mjedisin pyjor e kullosor me qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e pyjeve dhe kullotave si edhe parandalimin e rënies së zjarreve. Afati i realizimit: **gjatë gjithë vitit**.
- Njësia e Administrimit të Pyjeve gjatë periudhës së emergjencës (maj-tetor) të ketë të njohur në çdo moment lëvizjet e punonjësve. Për çdo lëvizje të lihet nr i telefonit celular dhe familjar. **Afati i realizimit maj-tetor**.
- Rojtarët dhe Teknikët pyjorë (persona përgjegjës për zonat pyjore) gjatë periudhës së emergjencës (maj -tetor) do të njoftojnë në Njësinë e Administrimit të Pyjeve pranë

Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, 4 herë në ditë ora 8:00, 11:00, 15:00 dhe 18.00 mbi situatën në zonën e tyre. Për këto njoftime do të mbahet **Libri i Gatishmërisë** (mos njoftimi e ngarkon me përgjegjësi direkte). Afati i realizimit maj-tetor.

– Njësia e Administrimit të Pyjeve pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve çdo të hënë dorëzon pranë Bashkisë Lezhë evidencën operative të situatës javore. **Afati i realizimit maj-tetor.**

- Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore, Rojtari dhe Tekniku i pyjeve (persona përgjegjës për zonat pyjore) kryejnë veprimet si më poshtë:

1. Njofton menjëherë në numrin e telefonit 128 Shërbimin Zjarrfikës dhe 129 të Policisë së Shtetit ku prezanton veten me emër e mbiemër, tregon se ku jeni (vendndodhjen e saktë), tregon vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orjentuese me ta sakta, emrin e vendit , vendbanimit më të afërt apo objekte te njohura), tregon llojin e bimësisë që po digjet (dru, shkurre, bar etj).
2. Njofton Përgjegjës të Njësies së Administrimit të Pyjeve dhe i dërgon lokacionin ose parcelën pyjore ku ka rënë zjarri.
3. Njofton Administratorin e NJA ku ndodhet vatra e zjarrit.
4. Nëse vlerëson se mund të shuajë zjarrin me mjete rrethimore atëherë ndërhy, në të kundërt largohet në distancë.

- Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonën pyjore/kullosore, dhe marrjen e njoftimit nga Rojtari dhe Tekniku i pyjeve (persona përgjegjës për zonat pyjore), Administratori i Njësies Administrative, kryen veprimet si më poshtë:

1. Njofton Kryetarin e Bashkisë në pozicionin e Kryetarit të Shtabit ose njofton në grupin Whatsapp.
2. Njofton Strukturën e Njësies Vullnetare për shuarje zjarri e cila është ngritur dhe funksionon pranë Njësies Administrative në fjalë.
3. Të gjithë bashkë organizohen për shuarjen e zjarrit ose lokalizimin e tij deri në mbërritjen e forcave të specializuara të mbrojtjes nga zjarri.

- Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi mbledhet në çdo kohë që shihet e arsyeshme nga Kryetari saj. Në këto mbledhje do të analizojë gjendjen dhe do të përcaktojë masat në

vijueshmëri në përputhje me situatat që mund të krijohen. Përgatit dhe publikon komunikatën dhe informacione të tjera të nevojshme në funksion të situatës për punën e bërë në mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga zjarret.

- Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në rastet e “zjarreve masive” apo “zjarreve me përmasa të mëdha” sipas situatës që krijohet, i kërkon **Institucionit të Prefektit** në pozicionin e Kryetarit të Shtabit qëndror ndihmë për përballimin e situatës.


- Të gjitha strukturat e Bashkisë të cilat janë pjesë e këtij Plani Masash, duhet të përgatitin Programin e Detajuar për marrjen e masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri. Afati i realizimit maj 2023.

Bashkangjitur planit; tabela me të dhënat e Rojtarëve dhe Teknikëve që kanë në ruajtje pyje dhe kullota sipas Njësive Administrative, skema e organizimit dhe harta e Ekonomive Pyjore në të cilën pasqyrohen zonat me rrezikshmëri të lartë zjarri që përbëhen nga formacionet pyjore të halorëve (pishë e zeze, pishë e egër, pishë e butë etj).

HARTOI
PËRGJEGJËSI
Ing. Artan PALUSHI



DREJTORI
Nikolin PRENDI



DREJTORIA E BUJQËSISË, UJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
NJËSIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
TË DHËNAT E ROJTARËVE DHE TEKNIKËVE TË ZONAVE PYJORE SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE
NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJHMEN

Rojtari/Tekniku i zonës	Ekonomia Pyjore	Sipërfaqja në ha	Fshatrat Brenda zonës Pyjore /Kullosore	Numri Celularit
Geg Paloka	Ekonomia pyjore Molung	1714.07 ha	Pllanë, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh, Prull.	0682211890
NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLSH				
Rojtari/Tekniku i zonës	Ekonomia Pyjore	Sipërfaqja në ha	Fshatrat Brenda zonës Pyjore /Kullosore	Numri Celularit
Endrit Kthella	Ekonomia pyjore Molung	842.94 ha	Manati, Manati e Vjetër Grykë Manati	0695319666
Mark Lesaj	Ekonomia pyjore Molung	1149.44 ha	Lalm, Patalej, Gjash, Kaçinar, Velë.	0682360966
Pal Gjetaj	Ekonomia pyjore Molung	661.17	Grykë Manati Kolsh	0682535630
NJËSIA ADMINISTRATIVE KALLMET				
Rojtari/Tekniku i zonës	Ekonomia Pyjore	Sipërfaqja në ha	Fshatrat Brenda zonës Pyjore /Kullosore	Numri Celularit
Mirsad Lushaj	Ekonomia pyjore Zadrimë	1549.9 ha	Mërqi, Rraboshtë, Kallmet i Madh, Kallmet i Vogël.	0699119427
NJËSIA ADMINISTRATIVE BLINISHT				
Rojtari/Tekniku i zonës	Ekonomia Pyjore	Sipërfaqja në ha	Fshatrat Brenda zonës Pyjore /Kullosore	Numri Celularit
Shtjefen Lleshi	Ekonomia pyjore Zadrimë	1607.57	Troshan, Fishtë, Krajin, Kodhel	0672568646.

NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLDRE					
Rojtari/Tekniku zonës	Ekonomia Pyjore	Sipërfaqja në ha	Fshatrat Brenda zonës Pyjore /Kullosore	Numri Celularit	
Lenë Mirukaj	Ekonomia pyjore Mali i Kakarriqit	791.56 ha	Kakarriq	0694614493	
Nikoll Doshi	Ekonomia pyjore Mali i Kakarriqit	1201.04 ha	Torovicë, Shkëmbi i Kuq	0675360551	
NJËSIA ADMINISTRATIVE UNGREJ					
Rojtari/Tekniku zonës	Ekonomia Pyjore	Sipërfaqja në ha	Fshatrat Brenda zonës Pyjore /Kullosore	Numri Celularit	
Jak Zefi	Ekonomia pyjore Brinjat e Tërtonit	2651 ha	Kaluer, Ungrej, Sukagji	0685479628	
Pjeter Gjonocaj	Ekonomia pyjore Brinjat e Tërtonit	2602.62	Ungrej, Fregen	0693622206	
Pllumb Ndreca	Ekonomia Pyjore Brinjat e Kreshtës	2215.8 ha	Zimaj, Kalivaç, Rras, Fregen	0682129286	
Gjon Brokshi	Ekonomia Pyjore Brinjat e Kreshtës	2402.34 ha	Kashnjet, Sukagji, Kalivaç, Gjobardhaj	0684715669	
NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNGJIN					
Rojtari/Tekniku zonës	Ekonomia Pyjore	Sipërfaqja në ha	Fshatrat Brenda zonës Pyjore /Kullosore	Numri Celularit	
Prell Malaj	Ekonomia pyjore Mali i Kakarriqit	1393.04	Mali i Shëngjinit	0673977077	



ZB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË MBROJTJES CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 281/1 Prot.

Lezhë, më 31.03.2023

Lënda: Konfirmim vendimi.

KËSHILLIT TË BASHKISË

KRYETARIT TË BASHKISË

LEZHË

Bazuar në ligjin nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", në ligjin nr.57, datë 30.04.2020, "Për pyjet", në VKM nr.684, datë 02.09.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-komunave/bashkive, të ndryshuar, dhe në VKM nr.1080, datë 22.12.2010, "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të Vendimit nr.19, datë 29.03.2023, "Për miratimin e planit të masave për parandalimin, menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe krijimin e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

